

V E N D I M
Nr. 350, datë 18.7.2002

**PËR EMETIMIN E OBLIGACIONEVE AFATGJATA ME MATURIM MË TË MADH SE
NJË VIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 5 e 23 pika 3 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e Ministrisë së Financave të emetojë, në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, obligacione afatgjata, me afat maturimi më të madh se një vit dhe përdorimin e tyre brenda kuadrit ligjor në fuqi.
 2. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të përcaktojë procedurat teknike të emetimit, blerjes, maturimit dhe regjistrimit kontabël të këtyre obligacioneve afatgjata.
 3. Komiteti i administrimit të huave të brendshme të përcaktojë strategjinë e emetimit të obligacioneve afatgjata, në përputhje me programet në këtë fushë dhe planifikimin buxhetor.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko